



E nderuara familje

Duke parë interesimin e shumë familjeve shqiptare me banim në Kassel dhe rrethinë ju njoftojmë se këshilli organizativ dhe këshilli i prindërve kanë vendosur që mësimi plotësues në gjuhën shqipe të filloj në **shtator 2015**.

Meqenëse keni zgjedhur të jetoni në Gjermani sigurisht se për fëmijet tuaj prioritet kryesor duhet të jetë mësimi i gjuhës gjermane dhe integrimi i tyre këtu. **Mirëpo gjuha amëtare shqipe** është poaq e rëndësishme për zhvillimin dhe shanset e fëmijes tuaj në të ardhmen.

Studimet shkencore tregojnë se fëmijët që zotrojnë mirë gjuhën e tyre amëtare, kanë sukses edhe në shkollë dhe kjo duhet parë si përparësi shtesë në zhvillimin e inteligjencës së tyre.

Poashtu ju do ndjeheni krenar dhe të relaksuar kur fëmija juaj në pushimet në vendlindje do e befasoj gjyshin e gjyshën, dajën e axhën, tezën e hallën, shokun e shoqen, duke e folur një shqipe të pastër.

Tanimë na duhet edhe konfirmimi i juaj konkret. Andaj ju lutemi lajmërojeni fëmijën tuaj deri më datën **30.06.2015** për mësimin plotësues në gjuhën shqipe. Kjo do na ndihmojë të dijmë më saktë numrin dhe moshën e nxënësve në mënyrë që të bëjmë përgatitjet e duhura.

Të bashkangjitur në këtë letër keni rregulloren edhe formularin për regjistrim. Ju lutem njoftoni edhe miqët dhe rrethin tuaj në Kassel.

Me respekt

Këshilli organizativ

Këshilli i prindërve

Njëriun ulenë aq herë sa gjuhë flet